



Raport mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Situatë Rruge

Prezenca e fëmijëve në situatë rruge, duke lypur, jetuar apo duke punuar në rrugë është bërë fenomen shumë shqetësues. Sipas studimit të parë kombëtar, 2527 fëmijë jetojnë në situatë rruge në Shqipëri dhe mbi 700 prej tyre janë vetëm në Tiranë.

Fëmijët në situatë rruge janë ndër grupet më vulnerabel dhe që të gjitha të drejtat e tyre janë shkelur. Ata jetojnë në kushte të papranueshme fizike, sociale, psikologjike, nuk shkojnë në shkollë dhe shpesh herë janë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Duke synuar përmirësimin e gjendjes së fëmijëve, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë hartuar Planin e Veprimit “Ndhmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”.

Kjo iniciativë ka për qëllim të mbrojë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, nëpërmjet një qasje të plotë, të integruar dhe një ndërhyrje të koordinuar ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve të tyre. Një hallkë e rëndësishme e bashkëpunimit është pushteti vendor, ku janë ngritur Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF)

1. Plani i Veprimit dhe Mekanizmi i koordinimit ndër-institucional

Në 2014, u nënshkrua **Marrëveshja e Bashkëpunimit** midis **MMSR** dhe **MPB** “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe u hartua **Plani Kombëtar i Veprimit** “ Ndhmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”. Që prej muajit maj 2014, ka vazhduar puna për zbatimin e këtij plani dhe objektivave të tij. Sipas Marrëveshjes, koordinimi i zbatimit

të Planit është përgjegjësi e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Bazuar në këtë marrëveshje, për koordinimin e institucioneve në kuadër të nismës, është ngritur **Task-Forca** në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Në këtë Task-Forcë bëjnë pjesë përfaqësues nga: Agjencia e Fëmijëve, SHSSH, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Koordinatori Kombëtar Anti-trafik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria Arsimore Rajonale, Bashkia Tiranë dhe disa OJF si vëzhguese.

Përveç koordinimit, është detyrë e Agjencisë të monitorojë ecurinë e Planit të Veprimit për fëmijë në situatë rruge. Agjencia ka koordinuar takimet periodike të Task- Forcës, ku ka paraqitur raportet periodike të ecurisë së planit. Njkohësiaht aktorët e Task Forces kanë detyrimin të raportojnë për detyrat e lëna nga takimet periodike. Deri tani janë zhvilluar mbledhje të Task- Forcës.(29.5.2014, 31.07.2014, 9.10.2014, 15.01.2015) Problematikat që vijnë nga terreni, janë adresuar rregullisht në mbledhjet e Task- Forcës, duke synuar gjetjen e zgjidhjeve institucionale dhe funksionimin e mekanizmave ligjorë, në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Problemet e adresuara kanë gjetur zgjidhje falë bashkëpunimit, disa të tjera mbeten sfida të vazhdueshme.

Në zbatim të marrëveshjes po hartohet edhe “**Udhëzuesi procedural për fëmijët në situatë rruge**” i cili qartëson rolet dhe përgjegjësitë e aktoreve duke theksuar dhe njëherë se mbrojtja e fëmijëve dhe ofrimi i shërbimeve është përgjegjësi kryesore e pushtetit vendor.

2. Zbatimi i Nismës në Tiranë

Bashkëpunimi me njësitë vendore

Për mirëfunksionimin e procesit janë firmosur marrëveshje 3- palëshe mes Agjencisë, Kryetarëve të Njësive Bashkiake dhe organizatave që mbështesin në terren NJMF-të. Deri tani janë firmosur marrëveshjet nga të gjitha organizatat dhe nga 7njësi vendore, përkatësisht njësitë nr 1, 2, 3 , 5 , 6, 8, 9, 10.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijë (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e fëmijëve brenda territorit të njësisë. Pjesë thelbësore e punës është identifikimi përmes daljeve në rruge. NJMF – ja është është hallka ndërlidhëse që nga identifikimi deri në rehabilitimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge. Duke e parë rolin kyç të NJMF në këtë proces, shumë e rëndësishme është fuqizimi i NJMF-së. Për këtë arsye NJMF-të e Tiranës janë trajnuar mbi procedurat dhe çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

Në bazë të raporteve rezulton se janë ngritur skuadra terreni në **11 njësitë bashkiake të Tiranës**. Pjesë e skuadrave të terrenit janë NJMF-të përkatëse të njësive bashkiake dhe një punonjës social nga Agjencia e Fëmijëve, Shërbimi social Shtetëror si dhe nga OJF partnere në zbatimin e Nismës, nga ARSIS, SHKEJ, FBSH, Të ndryshëm & të Barabartë, Save the Children. Skuadrat e terrenit punojnë sipas kalendarit, një kopje e të cilit u është komunikuar çdo 2 javë dhe Kryetarëve të njësive përkatëse bashkiake. Skuadrat dalin me rotacion dy herë në

javë në terrenin e njësisë vendore që i përkasin, duke mbuluar gjithë ditët e javës me skuadra në terren, gjatë orareve të paradites (8.00 - 4.00.).

Monitorimi i terrenit kryhet edhe në oraret e mbasdites (18.00-20.00) dy herë gjatë javës. Ndërsa një skuadër del në terren gjatë fundjavës, të shtunën dhe të djelën sipas rasteve që paraqiten. Nga skuadrat e terrenit realizohen 30 dalje në javë, në muaj gjithsej 110 dalje në terren. Nga fillimi i vitit 2015 janë realizuar gjithësej rreth 440 dalje në terren.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit

Drejtoria e Policisë Tiranë dhe komisariatet e policisë kanë treguar gadishmëri për të bashkëpunuar në kuadër të nismës për fëmijët në situatë rruge. Impakti pozitiv i këtij bashkëpunimi është parë që në fillimet e zbatimit të nismës. Në muajt në vijim është insistuar që ky bashkëpunim të forcohet, duke qenë se në disa raste Bërthama koordinuese dhe NJMFj-të nuk e menaxhojnë dot situatën pa ndihmën e policisë. Bëhet fjalë për raste që me gjithë ndërhyrjen e skuadrës së terrenit, familjet në rrugë bëjnë rezistencë dhe nuk pranojnë të ndihmohen apo të largohen nga rruga bashkë me fëmijët e tyre.

Bashkëpunimi me policinë ka qenë dhe mbetet një pikë kyçe në rastet :

- në rast rreziku për skuadrat;
- në rast se fëmijët gjenden vetëm të pashoqëruar në situatë rruge (në këto raste fëmijët duhen shoqëruar tek qendra e emergjencës)
- në rast se ka rezistencë nga familja për të larguar fëmijët nga rruga
- në rast se duhet proceduar me kallëzim penal ndaj prindërve apo personave të tjerë që shfrytëzojnë fëmijët.

Bërthama pë koordinimin e Planit të Veprimit në Tiranë, kryesuar nga koordinatori (nëndrejtoresha e SHSSH) nga mbledhja në mbledhje ka ndjekur zbatimin e vendimeve të marra nga Task Forca. Është vendosur pranë SHSSH dhe ka funksion koordinues të të gjithë skuadrave të terrenit dhe aktorëve të tjerë të nevojshëm. Bërthama, gjithashtu luan një rol aktiv në mbështetjen, koordinimin, ekspertizë të drejtpërdrejtë në punën e të gjitha skuadrave të terrenit. Bërthama ka krijuar dhe përditëson databazën për fëmijët në situatë rruge, përmes së cilës monitorohet ecuria dhe hapat e ndjekur për secilin fëmijë dhe familje

Gjatë punës është identifikuar nevoja për të ndërhyrë drejtpërdrejt në komunitetet romë dhe egjiptiane sidomos ato që janë vendosur në periferitë e qytetit, siç janë komuniteti i Shkozës, Bregu i lumit, komuniteti pranë liqenit artificial. Eksperienca ka treguar që puna në komunitet ka efekt pozitiv për daljen e fëmijeve në rrugë.

Menaxhimi i rasteve të familjeve në situatë rruge

Në ndihmë të familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge, punohet rast pas rasti për menaxhimin e tyre. NJMF është aktori kryesor për menaxhimin e rastit. Pas identifikimit dhe vlerësimit të rastit, përmes vizitave në familje, NJMF mbledh aktorët e nevojshëm në tryeza teknike multidisiplinare dhe së bashku hartojnë planin e mbrojtjes së fëmijës. NJMF ndjek zbatimin e planit, nëse është e nevojshme dhe rishikimin e tij, deri në zgjidhjen e rastit. Aktorët nga arsimi, policia, Zyra e Punës, Shërbimi Social Rajonal, Shërbimi Social në Bashki, OJF mblidhen për të diskutuar për dhënien e ndihmës për familjet.

Përcaktimi i personave të kontaktit për menaxhimin e rasteve nga arsimi dhe shëndetësia ka lehtësuar procesin e bashkëpunimit institucional. Aktorët janë mbledhur sipas rasteve duke marrë përsipër detyra, siç janë shërbimet shëndetësore, referim për punësim, ndërhyrje nga policia, asistencë me shërbime ditore nga OJF, ofrim paketash ushqimore dhe mbështetje me qera për banesë.

Shërbimet e ofruara për familjet në situatë rruge gjatë menaxhimit të rasteve

- këshillim, ofrim shërbimesh nga qendrat ditore;
- regjistrim i fëmijëve në shkolla, kopshte, cerdhe;
- pajisje me certifikata;
- vaksinim i fëmijëve;
- transferim dokumentash;
- paketa ushqimore;
- aplikim për ndihmë ekonomike;
- ndërhyrje për asistencë mjekësore.
- referim dhe ndërmjetësim për punësim në Zyrat e Punës

Shumë familje që janë identifikuar në situatë rruge janë përfituese të Ndhmës Ekonomike. Gjatë procesit të menaxhimit të rasteve, disa prej tyre që nuk e kishin përfituar janë referuar pranë NJMF dhe kanë aplikuar. Nxitja për aplikim për NE, është bërë dhe për familjet të cilat tregojnë neglizhencë për plotësimin e dokumentacionit dhe proceduarave ligjore.

NJMF-të e Tiranës kanë organizuar 35 tryeza teknike multidisiplinare, 23 gjatë vitit 2014 dhe 12 gjatë këtij viti.

Rezultatet e deritanishme

| NUMRI I FEMIJEVE | NUMRI I FAMILJEVE | PERSHKRIMI |
|----------------------|-----------------------------|--|
| 93 fëmijë | Që u përkasin 41 familjeve | Nuk janë më në situatë rruge, në bazë të monitorimeve të vazhdueshme të bëra nga skuadra e terrenit. |
| 234 fëmije | Që u përkasin 126 familjeve | Janë identifikuar dhe ka filluar puna me to. Fëmijët dhe familjet janë kontaktuar, sensibilizuar për të drejtat e fëmijëve, janë referuar për të marrë shërbime te qendrat ditore të organizatave dhe janë orientuar për të kërkuar shërbime për fëmijët e tyre të zyrat e NJM |
| 37 fëmijë | | Janë regjistruar në shkollë falë bashkëpunimit me Drejtorinë Rajonale Arsimore |
| 8 fëmijë | | Janë regjistruar në kopësht |
| 2 fëmijë | | Janë regjistruar në çerdhe |
| 1 fëmije | | Në proces regjistrimi |
| 11 fëmijë | Që u përkasin 5 familjeve | Janë sistemuar në institucione të përkujdesit shoqëror për arsye se, me gjithë shërbimet e ofruara familjet kanë vazhduar të shfrytëzojnë fëmijët për lypje, ose nuk kanë pasur mundësi të përkujdesen për fëmijët e tyre të mitur dhe kanë kërkuar ndihmën e shtetit për përkujdesjen e tyre të përkohshme. |
| 15 raste te miturish | | Të evidentuar nga policia keqtrajtuar nga prinderit dhe te afermit sipas nenit 124/b qe jane referuar ne prokurori. |
| | 35 persona familjarë | Janë trajnuar, shoqëruar, referuar për punësim . |
| | 9 persona familjarë | Persona janë arritur të punësohen. |
| | 11 persona familjarë | Kane braktisur punën |
| | 15 persona familjarë | Kane refuzuar punën që u është referuar |
| | 35 familje | Janë duke u menaxhuar nga punonjësit socialë me shërbime <ul style="list-style-type: none"> • këshillim, ofrim shërbimesh nga qendrat |

| | | |
|--|--|--|
| | | <p>ditore;</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrim i fëmijëve ne shkolla,kopshte, çerdhe; • pajisje me çertifikata; transferim dokumentesh vaksinim i fëmijëve • sigurim i paketave ushqimore; • ndihme per te aplikuar për ndihmë ekonomike • ndërhyrje për asistencë mjekësore • referim dhe ndërmjetësim për punësim në Zyrat e Punës |
|--|--|--|

Regjistrimet në çerdhe/kopshte/shkolla

Nga informacionet e dërguara pranë sekretariatit të Task- Forcës nga punonjësit e NJMF dhe organizatave për regjistrimin e fëmijëve në situatë rruge në çerdhe/kopsht/shkollë për vitin akademik 2014-2015 rezultojnë :

Fëmijë të regjistruar në shkollë: **37 fëmijë**

Problemet që mund të kenë pasur me pajisjen me libra dhe çanta janë suportuar me ndërhyrjen e Bërthamës nga NJMF-të dhe organizatat si TDH dhe ARSIS. Komplete librash, çanta shkolle, pajisje didaktike janë dhuruar në kuadër të Nismës për qendrën SHKEJ. Në përgjithësi librat janë shpërndarë sipas urdhërit të MAS në shkolla dhe fëmijët në situatë rruge të regjistruar janë pajisur me to.

Për fëmijët e komunitetit të Liqenit Artificial, të cilët për shkak të disa vështirësive nuk nuk u arrit regjistrimi i tyre ne shkollë, është mundësuar nga Organizata ARSIS që me një furgon të vendosur në dispozicion të tyre, fëmijët transportohen çdo ditë pranë qendrës ditore të ARSIS, ku marrin mësim në klasat edukative.

Agjencia e Fëmijëve ka adresuar problematikat dhe rekomandimet në lidhje me arsimimin e fëmijëve në situatë rruge pranë DAR, Tiranë, duke synuar që të gjithë fëmijët e identifikuar në situatë rruge që janë në moshë shkollore të ndjekin shkollën.

Për vitin e ardhshem do të punohet që të gjitha grupmoshat, si ata që regjistrohen për herë të parë, ashtu dhe ata që jnuk kanë pasur mundësinë të ndjekin shkollën edhe pse e kanë mbushur moshën, do të jenë pjesë e sistemit arsimor në Tiranë. Kjo do të kërkojë shumë përpjekje dhe angazhim institucional, si dhe rritje të vetëdijes së komunitetit dhe të stafeve pedagogjike në shkollat e Tiranës.

Çerdhet/kopshtet:

Regjistrimi në çerdhe dhe kopsht i fëmijëve në moshat 0-6 vjeç është problematik. Nga identifikimi i skuadrave të terrenit, një numër i madh fëmijësh të identifikuar në situatë rruge janë në moshë çerdheje dhe kopshti: **33 fëmijë** në moshë për çerdhe dhe **34 në moshë për kopsht**.

Duke parë vështirësitë për regjistrim në çerdhe, SHSSH u drejtua me një shkresë Zyrtare Qendrës së Zhvillimit Ekonomik dhe Zhvillimit të Fëmijëve, në Bashkinë Tiranë ku i kërkonte sigurimin e vendeve për regjistrim në çerdhe për për 33 fëmijët e identifikuar. U arrit të siguroheshin vetëm 6 vende vakante. Nga këto vetëm 3 fëmijë arritën të regjistrohen për shkak të vështirësive ekonomike të familjeve për të mbajtur një higjenë të pranueshme për fëmijët, stigma ndaj tyre, mungesa e dokumentacionit dhe pamundësia e marrjes së kontratave të qerave, të nevojshme për transferimin nga një njësi në një tjetër

E ngjashme është situata dhe me kopshtet. Numri i fëmijëve të regjistruar është 8 fëmijë, një numër shumë i vogël krahasuar me kërkesat.

Kjo situatë problematike ka pasoja në fuqizimin e familjeve nëpërmjet punësimit të prindërve, pasi shumica e prindërve i kanë fëmijët në moshë kopshti e çerdheje. Qendrat ditore që ofrojnë shërbime nuk kanë mundësi për këto mosha fëmijësh.

Në takimet e Task- Forcës janë diskutuar këto problematika me përfqësuesen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë, e cila ka pranuar që regjistrimet në çerdhe nuk u përgjigjen dot kërkesave të shumta, në rritje, duke shtuar që për fëmijët në situatë rruge, është akoma më e vështirë situata dhe që zgjidhja e saj është çështje komplekse që kërkon angazhim me prioritet.

Një nga pengesat për regjistrime në kopshte, çerdhe ka rezultuar që është dhe procesi i transferimit të vendbanimit, për familjet në situatë rruge, të cilat shpesh nuk banojnë në njësitë ku janë të regjistruara. Për të lehtësur këtë proces Agjencia e Fëmijëve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithëshme të Gjendjes Civile kanë hartuar një MEMO, drejtuar profesionistëve për mbrojtjen e fëmijëve. MEMO-ja qartëson procedurat e transferimit, bazuar në hapësira ligjore.

Sfidat për shërbimet në nivel Bashkie

- Në Bashkinë Tiranë aktualisht ekzistojnë 4 qendra komunitare të vendosura në 4 njësi bashkiake që ofrojnë shërbime për të gjithë komunitetin dhe kategoritë në nevojë. Në kuadër të Planit të Veprimit "Ndihmë për fëmijët dhe familjet në situatë rrugë", duhen planifikuar shërbime shtesë duke i mbështetur familjet në situatë rruge me

medikamente, vakte ushqimore, materiale didaktike , duke qene se këto qendra janë shumë pranë komuniteteve dhe nevojat për këto shërbime janë të shumta.

- Trajtimi me përparësi të fëmijëve në situatë rruge, duke u bazuar edhe në ne VKB Nr.3, datë 5.2.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” që i faforizon këto familje në pagesa dhe taksa regjistrimi, por dhe shtimi i aksesit për regjistrim në çerdhe.
- Shumica e NJMF në Tiranë edhe pse janë të reja janë aktivizuar në rastet e fëmijëve në situatë rruge, por do të duhet që ta luajnë gjithmonë e më fuqishëm rolin e tyre, duke bërë pjesë të punës qasjen pro-aktive sistematike në terren. Kjo realizohet vecanërisht përmes daljeve në terren , vizitave dhe ndjekje të rasteve në familje, duke e parë punën e tyre më së shumti larg “të qëndruarit në zyre.”

Punësimi

Punësimi i prindërve të fëmijëve në situatë rruge ka qenë i vështirë me gjithë përpjekjet e vazhdueshme.

Për të bërë të mundur punësimin e sa më shumë familjarëve si dhe për të patur një koordinim sa më të mirë mes Zyrës e Punës, Task Forcës së Fëmijëve në situatë rruge si dhe bizneseve dhe organizatave të ndryshme është ngritur një **grup pune prej tre personash**. Ky grup është përgjegjës krijimin e një databaze të personave që kërkojnë punë nga familjet e identifikuar në situatë rruge si dhe për sensibilizimin, trajnimin dhe monitorimin para dhe gjatë procesit të punësimit. Grupi i punës ka ndjekur të gjitha rastet e referuara nga Bërthama . Është punuar intensivisht me këshillim të familjarëve përmes vizitave në komunitet (Liqen , Shkozë, Godinat e Institutit të Kamzës, Bregu i Lumit tek njësia 11). Janë realizuar takime individuale për informim mbi fondin e nxitjes së punësimit si dhe është bërë e mundur regjistrimi i disa prej anëtarëve të gatshëm pranë zyrave të punës.

Fondi i nxitjes së punësimit duhet të këtë më tepër në prioritet target grupin e familjeve në situatë rruge, pasi deri tani nuk ka pasur raste që të kenë përfituar nga ky fond.

Për të rinjtë janë ofruar ndjekja e grupeve të këshillimit mbi punësimin si dhe kurse profesionale të ndryshme.

Deri tani ka patur **9 raste të suksesshme punësimi**. Edhe pse është bërë një përpjekje serioze për mbështetjen për punësim të këtyre familjeve janë 15 raste të refuzimit të vendeve të gjetura të punës dhe 11 raste që pasi kanë filluar punën e kanë braktisur atë.

Vështirësitë dhe sfidat për punësim

- Mungesa e besimit të bizneseve për të punësuar të rinj dhe të rritur Rom dhe Egjiptianë.

- Adultët dhe të rinjtë edhe në rastin kur bien dakord për të punuar nuk kanë arsim dhe eksperiencë në asnjë lloj pune apo profesioni.
- Hezitimi dhe mungesa e dëshirës për të punuar tek një pjesë e konsiderueshme e target grupit që po mbështeten .
- Probleme me strehimin, sistemimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte.

Fushata sensibilizuese

Në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit ka vazhduar dhe Fushata sensibilizuese vullnetare në ndihmë të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge që prej muajit shtator ku janë përfshirë rreth 100 vullnetarë. Nga shtatori deri në dhjetor 2014 janë shpërndarë rreth 16 mijë fletëpalosje dhe janë sensibilizuar mijëra qytetarë. World Vision ka mundur pajisjen me bluza për 100 vullnetarë dhe ka siguruar rreth 8 mijë fletëpalosje.

Për periudhën e festave të fundvitit fushata sensibilizuese qytetare pati në fokus të saj thirrjen drejtuar qytetarëve për të dhuruar për fëmijët në situatë rruge. Qëllimi ishte sensibilizimi dhe rritja e vëmendjes për fëmijët në nevojë dhe në ndihmë të atyre familjeve dhe fëmijëve të cilat nuk po dalin në rruge dhe janë drejt rrugës së rehabilitimit. Iu bë thirrje qytetarëve, bizneseve, studentëve, nxënësve, nëpunësve për të dhuruar ndihma, dhurata, paketa, lodra për fëmijët në situatë rruge. Rreth 60 familje në situatë rruge në rrugën e integritit u ftuan në një ceremoni ku morën dhurata dhe paketa ushqimore. U përgatitën dhe u shpërndanë 300 pako me lodra, veshje për 150 fëmijë të identifikuar në situatë rruge.

Ne ditën e Verës 14 Mars, Agjencia e Fëmijëve së bashku me organizatat partnere dhe me pjesëmarrjen vullnetarëve dhe femijeve festuan te këndi i fëmijëve në Parkun Rinia. Përveç festimeve u informuan dhe u sensibilizuan qytetarët dhe fëmijët mbi të drejtat e femijeve, përgjegjësitë prinderore, për shfrytëzimin e femijeve në situatë rruge, dhe ndihmën që ofrojnë qendrat ditore dhe organizatat për fëmijët në nevojë. Cdo dy jave po realizohen vizita sensibilizuese në komunitet për t'u ardhur në ndihmë familjeve në situatë rruge.

3. Prezantimi dhe përhapja e Planit të Veprimit për Fëmijë në situatë rruge në bashkitë e tjera.

Në vitin 2015, modeli i Tiranës do të zbatohet në rrethe të tjera duke marrë parasysh praktikën e mira që janë zhvilluar nga puna e NJMF-ve në Tiranë. Janë planifikuar këto rrethe, që e kanë të përhapur fenomenin e fëmijëve në situatë rruge në nivel kombëtar.

Bazuar në studimin kombëtar janë identifikuar :

- Në qarkun Elbasan, 98 fëmijë në situatë rruge.
- Në qarkun Durrës 205 fëmijë në situatë rruge
- Në qarkun Fier 113 fëmijë në situatë rruge

Puna ka nisur me realizimin e trajnimit që organizoi Agjencia e Fëmijëve në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit në tre qarqe: Durrës, Elbasan, Fier me temë “Fëmijët në situatë rruge, Identifikimi rasteve të trafikimit të brendshëm të tyre. Sfidat dhe zgjidhjet”. Prezantimi i Agjencisë u ndal në mënyrë të detajuar te mënyra e funksionimit të modelit të nismës për Tiranën dhe rezultatet e deritanishme,

- Janë organizuar takime me kryetarët e bashkive të përfshira me qëllim njohjen me Planin e Veprimit dhe bashkëpunimin në nivel bashkie.

- Agjencia po koordinon në bashkëpunim me aktoret lokale zbatimin e planit të veprimit për fëmijë në situatë rrugë në tre bashkitë e sipërpërmendura që synon:

1. Ngritjen e mekanizmit të koordinimit në nivel bashkie: Durrës, Elbasan, Fier. Takime për ngritjen e skuadrave dhe mekanizmit të koordinimit
2. Trajnimi i grupeve të terrenit që do punojnë për zbatimin e Planit të Veprimit
3. Përditësimi dhe mirëmbajtja e databazës së qendërsuar me rastet e fëmijëve në situatë rruge.
4. Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese në çdo bashki.

